



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:919575
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05479828

Ac.nr.267/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli kryetare e kolegjit, Nehat Idrizi dhe Dardan Kadolli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.K. nga Vushtrria, rr. “.....” p.n, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sh.A. avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS sh.a, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulimi i vendimit për ndërprerjen e kontratës së punës dhe kompensimin e pagave, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 2559/16 të datës 25.06.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS sh.a, me seli në Prishtinë, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2559/16 i datës 25.06.2019, dhe HEDHET poshtë padia e paditëses B.K. nga Vushtrria, e parashtruar me datë 31.10.2016.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr. 2559/16 të datës 25.06.2019, ka vendosur si në vijim:

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses B.K., nga nga Vushtria, IT. "...." p.n.

II. ANULOHET vendimi i të paditurës KEDS sh.a. Nr. ... i datës 27.09.2016, dhe OBLIGOHET e paditura KEDS - sh.a. që paditësen Bahrije Krasniqi ta kthej në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrat sipas kontratës së punës.

III. DETYROHET e paditura KEDS - sh.a. me seli në Prishtinë, që paditëses B.K ti paguaj shumën prej 7,693.70 euro neto për periudhën 01.12.2016 deri me 30.04.2019, në emër të trustit pensional e ia paguaj shumën prej 794.60 euro, si dhe tatimin në pagë në shumë prej 252.30 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% e cila llogaritet nga data 02.04.2019 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

IV. Pjesa tjetër e kërkesëpadiisë mbi shumën e gjykuar nga pika III. e dispozitivit të këtij aktgjykimi REFUZOHET SI E PABAZUAR.

V. OBLIGOHET e paditura KEDS, Sh.A., që paditëses t'ia paguaj shumën prej 379,20 euro, në emër të shpenzimeve gjyqësore, brenda afatit prej 7 ditësh

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën ta aprovoj si të bazuar dhe aktgjykimin e atakuar ta prishë, ndërsa lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

E paditura me parashtresën e datës 26.09.2019, ka njoftuar gjykatën e shkallës së dytë se në çështjen konkrete palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore dhe në këtë mënyrë kontesti mes ndërgjyqësve edhe ka përfunduar. Këtë fakt e paditura e ka konfirmuar edhe përmes shkresës elektronike të dërguar me datë 06.03.2024, të cilës i janë bashkëngjitur dokumentet e skanuara nga origjinali dhe atë Marrëveshja nr. 83, dt. 24.09.2019 dhe konfirmimi bankar dt. 24.09.2019.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, dhe vlerësimit të parashtresës së palës së paditur të datës 26.09.2019, dhe dokumenteve tjera relevante nga të cilat vërtetohet arritja, dhe përmbushja e marrëveshjes jashtëgjyqësore mes ndërgjyqësve, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që:

Ankesa e të paditurës të pranohet si e bazuar, aktgjykimi i atakuar të priset ndërsa, në mungesë të interesit juridik, padia të hedhet poshtë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar ka aprovuar kërkesëpadiinë e paditëses si të bazuar, duke e detyruar të paditurën që paditësen ta kthej në vendin e mëparshëm të punës, me të gjitha të drejtat dhe detyrat sipas kontratës së punës, me detyrimin që për periudhën kohore nga data 01.12.2016 deri më 30.04.2019, paditëses t'i paguhet shuma prej 7.693.70€, në emër të pagave të perealizuara, t'i paguhet trusti pensional dhe tatimi në të ardhura, më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit C.nr. 2556/16.

Pas përfundimit të procedurës në gjykatën e shkallës së parë, lënda sipas ankesës së të paditurës është pranuar në Gjykatën e Apelit. Mirëpo para se të shqyrtohet ankesa në gjykatë është pranuar parashtresa e të paditurës me njoftimin se rrethanat kanë ndryshuar, pasi që ndërgjyqësit me datë 24.09.2019, kanë arritur marrëveshjen jashtëgjyqësore për zgjidhjen përfundimtare të këtij kontesti.

Me referim në përmbajtjen e Marrëveshjes nr. 83 dt. 24.09.2019, kjo gjykatë konstaton se paditësja me vullnetin e lirë ka deklaruar se nuk dëshiron të kthehet në punë, por pranon kompensimin e ofruar nga KEDS në shumën prej 9248€, duke shtuar se KEDS lirohet nga çdo përgjegjësi e shkuar, e tashme dhe/ose e ardhshme në lidhje me kontratën e punës dhe ekzekutimin e vendimit të Inspektoratit të Punës si dhe aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 2559/16, dt. 25.06.2019. Për më shumë, nga provat shkresore rezulton se e paditura me datën e njëjtë nga lidhja e marrëveshjes jashtëgjyqësorë, përkatësisht me datë 24.09.2019, ka bërë pagesën e shumës së tërësishme në emër të kompensimit të dakorduar, duke u liruar kështu nga obligimet e marra në raport me paditësen.

Meqenëse palët ndërgjyqëse kontestnin e kanë zgjidhur me marrëveshje jashtëgjyqësorë, prandaj Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vendosi që aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe padinë konkrete ta hedh poshtë, në kuptim të dispozitës së nenit 2 paragrafi 4 të LPK-së, sipas të cilës përcaktohet se: *“Pala duhet të ketë interes juridik për padinë dhe për veprimet procedurale tjera që mund të kryhen në procedurë”*,

Rrjedhimisht, nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 paragrafi 1 pika b) lidhur me nenin 391 par.1 pika e) të LPK-së, kolegji i kësaj gjykate vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.267/2020 me datë 13.03.2024

Kryetarja e kolegjit,

Hunaida Pasuli